

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

15.03.2023
Ora 12:08

RENDI I DITËS

Projektakti “Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj Znj. M. Koja,

Znj. I. Osmanaj

• **Persona te Interesuar:**

Sipas Listës bashkelidhur

• **Të tjerë:**

KRIIK, Qëndresa Qytetare

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëhere, në seancën e sotme publike në rend të ditës kemi dy çështje për shqyrtim: Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 3 Mars – 9 Mars 2023. Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, po zonja Koja.

Znj. M. Koja: Atëhere, Komisioner në vijim të procedurës për hetimin administrativ për rastet kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është vënë në dijeni nëpërmjet indicieve apo denoncimeve konkrete nga palë të treta. Ju informojë si vijon: ka vijuar hetimi administrativ për çdo rast publik denoncimi dhe ka

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

përfunduar hetimi për 23 institucione publike, për 52 veprimtari publike për të cilat pretendohet se nuk janë raportuar në ndërfaqen e dedikuar për raportimin e veprimtarive publike në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa për katër rastet e tjera denoncohet se ka keqpërdorim të burimeve publike gjatë zhvillimit të veprimtarive. Sot janë thirur në fakt për të dhënë shpjegimet e tyre 19 institucione dhe do të më duhet që të pyesim nëse janë prezente dhe nëse kanë pretendimet e tyre për ti shprehur në seancë. Por përpara se të kërkojmë këtë, ju informojë që institucionet që janë thirur është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për një veprimtari për konstatim të keqpërdorimit të burimeve publike dhe mos raportim të veprimtarisë publike dhe denoncues kanë qenë “ Qëndresa Qytetare” dhe sot janë të pranishëm në seancë. Është Bashkia Gjirokastrë, për katër veprimtari publike të pa raportuara kërkuar shtyrjen e seancës në seancën e kaluar dhe vijojmë sot hetimin për këtë institucion. Janë Bashkia Konispol, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes për dy veprimtari të pa raportuara, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës për dy veprimtari publike të pa raportuara në rastin konkret ne konstatojmë se vetëm njëra prej tyre përbën veprimtari publike ndërsa njëra nuk është me natyrë publike por është me natyrë politike dhe për këtë arsye nuk ka detyrim për tu raportuar në ndërfaqe. Është Bashkia Korçë për dy veprimtari të pa raportuara dhe për këtë ne kemi bërë një verifikim. Këto veprimtari janë raportia via email për shkak se kanë pasur pa mundësi për tu raportuar në ndërfaqe dhe ne e kemi administruar këtë provë. Është Bashkia Kavajë për dy veprimtari të pa raportuara. Është Bashkia Elbasan për një veprimtari publike me përmbajtje elektorale dhe mos raportim të veprimtarisë. Prefekti i Qarkut Durrës për një veprimtari të pa raportuar, Bashkia Poliçan dhe kjo për dy veprimtari të pa raportuara. Bashkia Bulqiz për dy veprimtari të pa raportuara. Bashkia Belsh për një veprimtari të pa raportuar. Bashkia Skrapar për

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

një veprimtari publike të pa raportuar. Është Bashkia Maliq për 14 veprimtari publike të pa raportuara. Bashkia Lezhë për 6 veprimtari. Bashkia Tiranë për 4 veprimtari të pa raportuara, është Enti Kombëtar i Banesave për një veprimtari të pa raportuar. Bashkia Kukës për 4 veprimtari publike të pa raportuara.

Z. I. Celibashi: Ju faleminderit! Atëhere, përfaqësuesi i qëndresës me sa shoh është këtu, dhe nëse dëshiron që të marri fjalën për çfarë është paraqitur në raportin e tyre . Përndryshe ose vazhdojmë me përfaqësuesit e institucioneve unë nuk ju njoh gjithëseclin prej jush, por unë do tu jap fjalën por nëse dëshiron përfaqësuesi i qëndresës fillimisht fjala është për ju. Faleminderit!

Z. Rigels Xhemollari, Përfaqësuesi i Qëndresa Qytetare: I nderuar Komisioner, ne sot kemi dy çështje të cilat lidhen me përdorimin e burimeve shtetërore. Një me Ministrinë e Shëndetësisë dhe tjetra me Bashkinë e Konispolit, sigurisht ne i qëndrojmë pretendimeve që kemi në rastin tonë. Kemi aktivitet të pa raportuar dhe një aktivitet ku janë përdorur burime publike konkretisht spitali Lezhë për të promovuar investime aktuale dhe investime në të ardhmen në prani të drejtuesit politik të Partisë Socialiste deputetit të Partisë Socialiste dhe me sloganet e Partisë Socialiste në postimin e saj. Unë mundet ti lë fjalën institucioneve dhe më pas mundet që të kem pretendime. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po faleminderit! Më së pari nga Ministria e Shëndetësisë dhe Bashkia e Konispolit kemi present? Po, ju lutem prezantohuni, emër- mbiemër dhe funksionin .

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

Z. Olsi Akshiaj personi përgjegjës i autorizuar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: Përshëndetje i nderuar Kryetar! Jam Olsi Akshiaj personi përgjegjës i autorizuar bashkë me zonjën Alma Dervishaj për të përfaqësuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me këtë procedim nga procedura administrative. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me hetimin administrativ që po zhvillohet nga KQZ i nderuar, ka kthyer edhe përgjigjen zyrtarisht me shkresën nr. 936 /1 ku shkurtimisht në mënyrë të përmbledhur argumentohet që raportimi është bërë në kohë reale dhe konformë procedurës. Arsyeja besoj që qëndra nuk ka arritur dotë të gjej raportimin është sepse mund ta ketë kërkuar me Ministria e Shëndetësisë dhe jo me Spitali Lezhë. Kemi bashkëlidhur edhe në shkresën raportimin që është bërë në kohë reale dhe në konformë parashikimeve të ligjit. Për sa i përket argumentimit në lidhje me fondet me përdorimin e fondeve sqarojmë se promovimi i investimeve në dispozicion është përpara datës 13 Janar 2023 dhe nuk përfshihet në kategorinë e veprimtarive të ndaluara në vendimin e datës nr.9, 24.12 si dhe fjala e pjesmarrësve gjithmonë nuk ka qenë me ngjyrimë partiake. I qëndrojmë argumentimeve dhe vlerësojmë se kërkesa është e pa mbështetur e “Qendrës Qëndresa”. Faleminderit!

Z. Rigels Xhemollari, Përfaqësuesi i Qëndresa Qytetare: Mos është një ngatërresë domethënë se bëhet fjalë për aktivitetin e datës 7 Shkurt në Spitalin Rajonal të Lezhës, jo në Janar. Po për 7 Shkurtin, ju pretendoni që është bërë aktiviteti në Janar?

Z. Olsi Akshiaj personi përgjegjës i autorizuar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale: I nderuar referuar replikës përfaqësuesit të Qendrës Qëndresa

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

sqarojmë se ka të bëjë me fondet që janë vendosur në dispozicion përpara datës 13 Janar 2023 dhe nuk ka të bëjë me datën e organizimit të eventit.

Z. I. Celibashi: E kemi të qartë për çfarë pretendohet. Keni diçka për të shtuar përfaqësuesi i qëndresës?

Z. Rigels Xhemollari, Përfaqësuesi i Qëndresa Qytetare: Atëhere, i nderuar Komisioner jemi përpara faktit, ku drejtuesi politik i qarkut në këtë cilësi është shprehur edhe në postimin që është bërë edhe nga vetë institucioni. Ministrja e Shëndetësisë, Kryetar i bashkisë dhe deputeti i Partisë Socialiste vizitojnë një aset publik që është Spitali Rajonal Lezhë ku kryejnë një veprimtari publike dhe promovojnë investime të kryera dhe të kryera në të ardhmen që do të thotë. Unë mund tui citojë shërbimin e radiologjisë dhe ndërtimi i Spitalit Kurbini që është një investim i bërë dhe fillimi i investimeve për spitalin Mirditë. Që do të thotë dalim nga Lezha dhe shkojmë në nivel qarku dhe në nivel politik. Vendimi nr.9 i ndalon ministrin të marrë pjesë të drejtojnë dhe të kontribuojnë në veprimtaritë publike të ndaluara. Neni 3 pika 1/b ndalohen të promovohen veprimtaritë publike që mbështeten dhe promovojnë projektin investime në fushën e shëndetësisë. Natyra politike e këtij aktiviteti ku përdoret aset publik në rastin tonë spitali Lezhë vërehet qartë edhe nga prezenca e drejtuesit politik zotit Ulsi Manja dhe deputetit zotit Eduard Ndreca. Hashtagu është nuk ka kohë për pushim edhe është slogani i Partisë Socialiste në zgjedhjet e shkuara. Duke synuar pra mbështetjen e kësaj partie në këto zgjedhje. Bazuar në nenet 91, 92, 171 dhe 172 ne kërkojmë konstatimin e përdorimit të burimeve shtetërore nga Ministrja e Shëndetësisë përmes mbështetjes dhe promovimit të spitalit, të investimeve në spitalin e Lezhës. Konstatimin e shkeljes së detyrimit për të raportuar veprimtarinë publike që ne na

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

rezulton se nuk është raportuar në ndërfaqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndëshkimin e Ministrir të Shëndetësisë, ndëshkimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe sigurisht ndëshkimin e Drejtorit të Spitalit Rajonal për vënien në dispozicion të këtij aseti për përdorime politik. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Po faleminderit! Kishit diçka tjetër për të thënë, për ta mbyllur, meqenëse ju takon fjala e fundit!

Z. Olsi Akshiaj personi përgjegjës i autorizuar i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale: I nderuar Kryetar i qëndrojmë argumentimeve, si në pjesën e parë të kërkesës së dispozitivit të palës kërkuese që raportimi është bërë në kohë reale. Vërtetuar nga dokumentat e bashkëlidhur raportimit. Përsa i përket përdorimit të fondeve sqarojmë që jemi në kushtet që përdorimi i fondeve përpara datës 13 Janar 2023 dhe nuk përfshihemi në kategorinë e veprimtarive të ndaluara. Sa më sipër them që kërkesa të mos pranohet. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë vazhdojmë me institucionet e tjera sipas rradhës!

Znj. Elena Boriçi, zv.Drejtor i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave: Lidhur me aktivitetin për të cilin është bërë denoncimi i zhvilluar nga Enti Kombëtar i Banesave. Ju bëjmë me dije se është një vizitë rutinë e titullarit të institucionit në kantierin e punimeve të ndodhur në qytetin e Burrelit. Kanë qenë pjesëmarrës në atë vizitë vetëm nga ana e insitucionit vetëm titullari i institucionit gjithashtu edhe pjesëmarrës nga shoqëria sipërmarrëse e cila po zhvillon punimet për ndërtimin e objektit. Vlen të theksojmë se nuk ka pasur pjesëmarrje nga

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

përfaqësues politik, gjithashtu nuk ka pasur pjesëmarrje as nga shoqëria civile. Ndër të tjera dua të theksojë se institucioni nuk ka pasur edhe akses për tu loguar në ndërfaqen e KQZ-së për shkak se kemi pasur kredencialet e zgjedhjeve të kaluara, kemi tentuar që të logohemi me ato kredenciale po ka qenë e pa mundur. Kemi pasur komunikim përmes email me KQZ-në dhe jemi në pritje të passëord të ri në mënyrë që të logohemi në faqe.

Z. I. Celibashi: Faleminderit ju kuptova! Do të bëjmë një verifikim lidhur me këtë pretendim. Po vazhdojmë me institucione të tjera. Ju të Ministrisë së Shëndetësisë mund të largoheni dhe ju të Entit të Banesave.

Përfaqësuese e Drejtorisë Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe aftësive: Përshëndetje! Ne faktikisht akuzohemi për punësim, ndërkohë që dhe duhet të theksohet që 3 deri në 6 muaj. Ndërkohë që institucioni jonë nuk ka staf të përkohëshëm . Ne jemi agjensi e cila implementon programe nxitjesh punësimi vërtet por të cilat akoma nuk janë konfirmuar për vitin 2023. Që do të thotë që nuk ka asnjë lloj dhe nuk janë punësimë por janë programe të ndryshme në fushën e integritetit për çdo individ i cili është i përvitshëm besoj e dini dhe llojin e aktivitetit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Ndërsa për sa i përket ndryshimeve që janë bërë të kategorisë së punonjësve ekzistentë ku i pari është i punësuar në vitin 1992 dhe i fundit është i punësuar në 17.11.2022 që do të thotë nuk ka asnjë lloj punësueshmërie të re. Me vendim të Kryeministrit për disa rregullime për sa i përket mirëfunksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit i cili ka dalë në 30.12.2022 urdhër 210. Ndërsa për sa i përket urdhër 80, dt.30.12 të Kryeministrit për disa ndryshime në urdhërin 172 ,dt .24.12.2019 për miratimin e strukturës dhe të organikës së AKPA-së i ndryshuar. Ku citohet ndryshimi i

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

kategorisë 4C në 4B të individëve të punësuar. Për shkak se në punojmë sistemi financiar i joni është i lidhur me HRMIS nuk e di a keni pak a shumë të qartë. Në momentin që ndërrohet kategoria duhet të fshihen punonjësit që janë ekzistent dhe të rikthehen me kategorinë e re. Nuk mund të merret kategoria pa u hequr nga sistemi, ndërkohë kontratat e personave që nga ristrukturimi i agjensisë nga SHKP që u kthyem në Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe të Aftësive fillojnë nga data 16.12.2020 të ribërat. Ndërsa sa i përket ndryshimit të kategorisë efektet financiare fillohen nga 01.09.2022 me urdhër të Kryeministrit dhe ndryshimit të ardhura në drejtori urdhëri përkatës është 13.01.2023. Aneksi i përkatës nuk ka kontratë shtesë ka vetëm një aneks në kontratë. Ku citohet qartë neni 2, në nenin 7 të paragrafit 1, ndryshohet kategoria e pagës nga 4C në kategorinë e pagës 4B. Struktura e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Drejtorisë Rajonale Elbasan më saktë është prej 24 individësh aktualisht dhe nuk ka asnjë ndryshueshmëri. Ju kam kthyer një përgjigje që mund të bëni verifikimin në DPT ku shumë qartë shikohet që emrat e personave ekzistentë janë po të njëjtët e emrave të personave që kanë qenë përpara ndryshimit të kategorisë. Kjo është bërë vetëm me zyrat vendore të cilat kishin një kategori të mangët. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit juve! Atëhere, vazhdojmë me institucionet e tjera .

Znj. Diana Dervishi, Autoriteti i Konkurrencës, Sekretare e Përgjithshme: Jemi thirrur këtu në lidhje me gjetjet e rekomandimeve dhe raportin e gjetjeve të datës 3 Shkurt 2023 dhe 9 Shkurt 2023. Duam shkurtimisht të sigurojmë KQZ-në që Autoriteti i Konkurrencës në datën 24 Janar 2023, ka realizuar një takim stimulus në kuadër të zhvillimit të takimeve të organizuara me mbështetjen projektit SANECA. I cili mbështet Shqipërinë për përgatitjen e negociatave të anëtarësimit

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

në BE dhe bëhet fjalë për kapitullin 8 ku ne jemi lider të këtij kapitulli. Gjithë dokumentacionin dhe autorizimin e sotëm e kemi përgatitur në një dosje kërkoj që të merret në konsideratë nga Kryetari dhe KQZ. Shumë faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Institucionet e tjera kush janë prezent? Ju lutem, kaloni përpara.

Z. Ermir Çela, Drejtor i Zyrës Arsimore Vendore të Arsimit Parauniversitar Elbasan: Përshëndetje! Në email e ardhur nga institucioni juaj akuzohemi për punësime gjatë periudhës 13 Janar deri më 13 Mars. Desha të theksoj se punësimet e në arsimin parauniversitar funksionon në bazë të portalit “Mësues për Shqipërinë”. Të gjitha punësimet e kryera nuk janë mbi organikë por janë zëvendësime raporte, leje lindje duke ofruar shërbimin arsimor nxënësve të arsimit parauniversitar. Procedura e ndjekur në këto punësime zëvendësim raporte, leje lindje apo dalje në pension është mbi bazën e portalit “Mësues për Shqipërinë” mbi bazën e kërkesës së drejtorit të institucioneve arsimore. Kërkesat me email dhe mbi bazën e renditjes së pikëve për çdo kandidatë që kërkon të punësohet në arsimin parauniversitar. Në bazë të nenit 91 të Kodit Zgjedhor unë i quaj këto punësime të përligjura pasi i ofrohet një e drejtë kushtetuese për arsimim fëmijëve. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Vazhdojmë me përfaqësuesin e institucionit!

Z. Çelik Leka, Drejtor i Ujësjellës Kanalizime Elbasan: Përshëndetje! Akuzohem për punësime. Nga data 1 Janar shoqëria Ujësjellës Kanalizime Elbasan i kanë ikur të gjitha të drejtat për punësim pasi është krijuar shoqëria rajonale e

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

ujësjellësit Elbasan. Pasi drejtorja e Elbasanit dhe administratorit i kanë ikur të drejtat dhe aktualisht rezulton që vetëm administrator të jetë punonjës i kësaj shoqërie. Kështu që ne nuk kemi asnjë lloj kompetence për emërimë punësimesh. Nuk e di nëse jam i qartë këtë e vërtetojmë edhe nga listëpagesa e kontributeve që vetëm administrator është aktual. Thjesht jemi për çështje likuidimi deri në mbyllje të bilancit dhe pastaj shkrihet si shoqëri.

Z. I. Celibashi: Mirë faleminderit! Vazhdojmë me përfaqësues institucioni tjetër.

Z. Altin Musollari, përfaqësor Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të OSSH.sh.a Elbasan zotin Erald Sina: Tek instiucionet që përmëndët më parë nuk e dëgjova emrin e institucionit tonë,nuk e di mos ndoshta. Bëhet fjalë për punësime....

Z. M. Koja: Është çështje e mbartur nga hera e kaluar, prandaj.

Z. Altin Musollari, përfaqësor Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të OSSH.sh.a Elbasan zotin Erald Sina: Në rregull! Bëhet fjalë për punësime para fushatës zgjedhore, punësime ku pretendohet që janë punësime me kontrata me afat të caktuar 3-6 muaj dhe menjëherë iu kërkua burimeve njerëzore të Drejtorisë Qendror në Tiranë sepse unë e theksoj që OSSH.sh.a Elbasan nuk është punëdhënës. Drejtori i drejtorisë rajonale nuk lidh dot kontrata. Nuk hap dot procedura për rekrutim dhe nga përgjigja e ardhur nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore në Tiranë, e cila iu ka ardhur edhe juve me email bëhet fjalë që në këtë periudhë ka vetëm 2 punësime të cilat kanë qenë për të zëvendësuar vende vakante. Nuk ka asnjë kontratë me periudha të caktuara 3-6 mujore siç pretendohet. Jane vetëm dy punësime për të gjithë periudhën dhe janë me kontratë pa afat të caktuar dhe janë për të zëvendësuar vende vakante. Për modalitetet se si publikohen vendet

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

vakante, si thirren, si zgjidhen edhe njëher dua tui them se nuk duhet ti drejtoheni Drejtorisë Rajonale OSSH Elbasan por Drejtorisë së Burimeve Njerëzore pranë OSSHE Grup Sh.a Se ua kemi thkesuar edhe në email po keni ngulur këmbë që të paraqitemi ne për shpjegime dhe këto janë shpjegimet që kemi marrë nga kjo drejtori. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Në rregull faleminderit! Institucioni tjetër!

Z. Erion Lalaj Bashkia Kavaj, Sekretar i Përgjithshëm: Jam këtu për dy denoncime 129 dhe 89. Denoncimi 129 është po i njëjtë me vendimin nr.125 që ju keni marrë edhe vendim është një email i përsëritur dhe për denoncimin 89 nuk është aktivitet i bashkisë i institucionit tonë. Thjesht ishte një vizitë informale nga Unioni i Sipërmarrësve të Rinjë të Shqipërisë në bashkëpunim me Ministrinë e Rinisë dhe Fëmijëve dhe jemi lajmëruar vetëm një ditë përpra edhe është bërë vetëm një foto edhe është hedhur takim me të rinjtë, e Unionit të të Rinjëve Sipërmarrës. Nuk është fare aktivitet i institucionit tonë, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord, faleminderit! Vazhdojmë me institucionet e tjera!

Përfaqësues i Agjensisë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve: Sot na vjen njoftimi për një aktivitet të zhvilluar pa u bërë me dije KQZ-në. Për aktivitetin në Bashkinë Belsh, në takimin e Ministres, Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorit të AKU. Këtu është menduar që raportimi duhet të kryhej nga ministria dhe bashkia në fund nga ana jonë. Megjithatë aktiviteti nuk është i ndaluar sepse aty fondet janë të planifikuara nuk janë të alokuara për efekt fushate. Gjithashtu ne për raportimin kemi pasur probleme me kredencialet kemi

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023

bërë një njoftim pranë KQZ-së për dhënien e kredencialeve dhe nuk kemi marrë përgjigje akoma.

Z. I. Celibashi: Kur e keni dërguar këtë email për problemin që keni me aksesin? Në cilën adresë email në KQZ e keni dërguar?

Përfaqësues i Agjensisë Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve: Në Shkurt, në datë 22.... Nuk e mbaj mend të shoh shkresat...

Z. I. Celibashi: Bëni verifikimin dhe më thoni! Vazhdojmë me institucionet e tjera.

Znj. Stela Zeqja, Prefektura e Qarkut Durrës: Flitet për një denoncim në lidhje me një veprimtari të kryer nga Prefekti i Qarkut, që ka lidhje me mbledhjen e komitetit anti trafik. Kjo është një veprimtari rutinë periodike që prefekti i qarkut bën si kryetar, si kryesues i të gjithë këtij komuniteti anti trafik. Kjo është mbledhje periodike që kryhet minimalisht një herë në dy muaj nga prefekti pjesëmarrës në këtë mbledhje kanë qenë vetëm titullarrët e institucioneve që janë pjesë e këtij komiteti antitrafik. Nuk ka pasur pjesëmarrje as media, as shoqëri civile në këtë veprimtari të kryer. Konkretisht mbledhja e rradhës ka qenë në lidhje me analizën vjetore të komitetit anti trafik pra të gjithë pjestarët pra vetëm të këtij komuniteti pa asnjë të ftuar nga jashtë vetëm në lidhje me analizën vjetore të punës që ka bërë komiteti anti trafik me prefektin si kryetar i këtij komuniteti. Gjithashtu edhe ne kemi pasur probleme me kredencialet. I kemi dërguar email tonë në momentin që na ka ardhur email në lidhje me të dhënat e kontaktit por siç duket aty ka pasur një problem në lidhje me email e dërguar nga ne, dhe nuk kemi arritur

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

të marrim dot kredencialet. I kemi marrë ditën e Hënë me datë 13 Mars, kemi arritur të marrim domethënë të rregjistrohemi në këtë veprimtari, në këtë faqen e KQZ –së në lidhje me raportimet. I kam dërguar edhe me shkrim, ato prapësimet i kemi edhe me shkrim.

Z. I. Celibashi: Po institucioni tjetër! Bashkia Konispol më duket?

Z. Julian Uzeir përfaqësues i autorizuar Bashkia Konispol: Po përshëndetje Kryetar, kemi të bëjmë me denoncimin nr. 150 për Bashkinë Konispol. Jam perosini i autorizuar, autorizimin e dispononi ju. Në fakt argumentat e prapësimit i kemi dërguar në formën që na ka ardhur njoftimi me email zyrtarisht pranë jush. Në mënyrë të përmbledhur po ju rithem se aktiviteti ose takimi për të cilin bëhet fjalë është një takim i organizuar dhe i thirur nga komuniteti dhe nga kryesia e Fshatit Shalës, e cila është pjesë e Bashkisë Konispol. Pjesëmarrësit në këtë aktivitet kanë qenë në lartësinë e funksionit që ato mbajnë për funksionet që ato kryejnë. Dhe kanë qenë ato institucione të cilat kishin të bënin me problematikat që komuniteti ka ngritur pranë kryesisë së fshatit. Njoftimi pranë Bashkisë Konispol ka ardhur në një kohë shumë të shkurtër kohore le të themi një ditë përpara shkresën ju e dispononi. Në qoftë se ashtu mund tua vëmë në dispozicion për këtë takim për Kryetarin e Bashkisë i cili mban edhe datën 7 Shkurt. Dua të sqaroj se kërkesa që ka ardhur nga banorët ka qenë për zgjidhjen e disa problematikave të kahershme për atë fshat që kanë të bëjnë me çeshtje infrastrukturore. Gjithashtu dua të sqaroj se nuk kemi konflikt me ligjin zgjedhor nuk kemi konflikt me vendimin pasi këtu nuk është rasti i vënies në dispozicion të aseteve. Godina në të cilën është zhvilluar aktiviteti bëhet fjalë për një fshat të vogël me një numër shumë të vogël pjesëmarrësish , të gjithë ata që ishin pjesëmarrës ishin për shkak të

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

problematikave që kanë ngritur. Pavarësisht përkatësisë politike. Dhe qendra ose shkolla e cila është , godina e cila është vënë në dispozicion është një godinë e cila përdoret rregullisht për aktivitete të ngjashme pasi është e vetmja që është godinë publike në një fshat të vogël. Nuk ka godina të tjera edhe funksionon si qendër komunitare në atë zonë. I qëndrojmë argumentave që kemi vënë në dispozicion dhe në email. Sqarojmë gjithashtu se në aktivitet pjesëmarrja ka qenë minimale vetëm e qytetarëve që kanë ngritur problemet tek kryesia e fshatit dhe nuk ka pasur prezencë të mediave. Faleminderit!

Znj. M. Koja: Komisioner denoncues për këtë rast është Qëndresa Qytetare nuk e di nëse kanë ata ndonjë koment nga ana e tyre. Unë thjesht një pyetje kisha në fund...

Z. I. Celibashi: Ata i bënë të përmbledhura për të dyja edhe për rastin e Ministrisë së Shëndetësisë. Po keni fjalën!

Z. Rigels Xhemollari, Përfaqësuesi i Qëndresa Qytetare: Atëherë, në datën 9 Mars jemi sinjalizuar nga vëzhguesit tanë që në “Shkollën Raid Baja” të Shalës në Konispol është zhvilluar një takim në ambjentet e kësaj shkolle 9 vjeçare me pjesëmarrjen e deputetes së Qarkut Vlorë zonjës Anila Denaj dhe Kryetarit të Bashkisë Konispol zotit Shuaip Beqiri. Në postimin i cili është shpërndar thuhet se zonja Denaj shprehet se bëmë një takim me banorët e zonës dhe falë investimeve të realizuara është arritur përmirësimi në këtë zonë. Pastaj vazhdon me sloganin nuk ka kohë për pushim siç e theksova edhe më parë është një slogan i përdorur nga Partia Socialiste. Ne mendojmë dhe ne kallëzojmë se jemi në kushtet e keqpërdorimit të burimeve publike. Sigurisht shkollat kanë qenë një nga elementët

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

që ne që në fillim i kemi depozituar pranë institucionit tuaj ku konstatohet se ky burim publik pra shkolla i është vënë në dispozicion deputetit të Partisë Socialiste zonjës Anila Denaj dhe pjesëmarrja e Kryetarit të Bashkisë në këtë rast dhe vënia në dispozicion nga drejtori i shkollës i këtij aseti është një shkelje e Kodit Zgjedhor. Ndërsa përsa i përket shkresës e cila është depozituar pranë institucionit tuaj si përgjigje e kallëzimit, ne besojmë që në funksionet e kryetarit të bashkisë dhe të deputetit nuk lidhet me çështjet e rregullimit të rregjistrimit të pronave. Pra është Agjencia e Kadastrës ajo që merret me çështjet e rregjistrimit të pronave. Dëgjuesat ose konsultimet publike duhet të bazohen në ligjin për konsultimet publike, sipas rregullave të tilla thënë ligjin për vetëqeverisjen vendore, sipas Kodit Zgjedhor 4 muaj përpara zgjedhjeve është e ndaluar që të zhvillohen veprimtari në të cilat shpërndahen poste, diskutohet për çështje të titujve të pronësisë, të çfarë do lloji qofshin këto. Së fundimi ka një mospërputhje tek shkresa e fundit mes orarit të kërkesës të datës 7 e cila është ora 16 dhe orarit kur bashkia pretendon se është realizuar aktiviteti ora 14. Kjo mos përputhje ne dyshojmë se mundet të lidhet edhe me një shkresë justifikuese për kryetarin e bashkisë. Po kjo mbetet pastaj për në çështjet e hetimit dhe ndoshta edhe me një komunikim edhe me drejtorin e shkollës është marrë leja ose me drejtorin rajonal të arsimit a është marrë leja për tu zhvilluar ky aktivitet dhe a ka dhënë lejë për të zhvilluar një aktivitet të tillë në një aset publik. Faleminderit!

Z. I. Celibashi: Kishim diçka tjetër?

Znj. M. Koja: Jo, thjesht për të hedhur pak më shumë dritë por e konsumoj këtë pyetjen time qëndresa nëse pësa kohë organizimi është bërë nga sa pretendohet nga

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

Kryetari i Fshatit Shalës. Atëhere pjesa e organizimit është tek aksesimi në shkollë dhe nëse janë kryer procedurat, ndërkohë kjo ishte pyetja që e bëri qëndresa.

Z. Julian Uzeir, përfaqësues i autorizuar Bashkia Konispol: Atëherë orari i aktivitetit i takimit që është organizuar është orari 14 dhe ka qenë orari mbas funksioneve arsimore domethënë. Kjo duhet theksuar gjithashtu siç thash kjo godinë në një pjesë të saj funksionon edhe si një sallë ku bëhen edhe takime të tilla. Pastaj dhe interpretimi dhe keqinterpretimi për natyrën politike të takimit nuk e di, nuk është në dorën tonë.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord! Institucione të tjera?

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Unë jam lajmëruar për takimin por nuk e di për cilat pastime apo takime bëhet fjalë? Thjesht kam vetëm lajmërim dhe orën e takimit, nuk e di për çfarë.

Z. I. Celibashi: Nuk keni marrë njoftim me email për çfarë?

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Jo, për takimet jo, ose postimet jo. Po, kam vetëm lajmërimin për sot por jo për cilat postime bëhet fjalë. Do të zhvilloj seancë publike mbi hetimin administrativ të nisur ndaj instiucionit tuaj dhe thotë vetëm orën.

Znj. M. Koja: Atëherë, jeni njoftuar edhe më parë besoj me email në lidhje me një pretendim...

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Po është marrë një vendim për ato, tani kjo është tjetër.

Znj. M. Koja: Janë dy veprimtari publike të pa raportuara dhe bëhet fjalë për këto objekt në ditën ndërkombëtare të arsimit Kryetari i Bashkisë Bulqizë, organizon një takim me mësues dhe arsimdashës nga Bulqiza. E dyta është, “sot plot 75 vite nga krijimi zyrtarisht të minierës më të madhë të kromit në vend” është bërë një tjetër veprimtari nga ana juaj. Të dyja këto rezultojnë të pa raportuara në ndërfaqen e raportimeve.

Z. I. Celibashi: Ideja është që këto dy veprimtari ne na rezultojnë që janë zhvilluar ndërkohë nuk janë raportuar nga ana juaj. Nëse keni mundësi të jepni shpjegime përndryshe mundet të mendoheni ti dërgoni me email, nëse dëshironi.

Znj. M. Koja: Ne kemi një shkresë nga ana juaj për njërin nga veprimtaritë për 75 vjetorin e krijimit të minierës së kromit, ndërsa për tjetrën nuk kemi informacion dhe prandaj ju kemi thirur.

Z. I. Celibashi: Për njërin prej veprimtarive për të cilën e prezantuar ju keni dhënë shpjegime, për tjetrën jo. Nëse mundeni të jepni tani shpjegime nëse jo mund ta shtyjmë një ditë tjetër ose mund ti sillni me email.

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Atëhere. Më mirë ti sjellë me email sepse nuk e di...

Z. I. Celibashi: Po e keni të qartë për çfarë bëhet fjalë, për veprimtarinë e dytë?

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publiketë
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Po, po!

Z. I. Celibashi: Në lidhje me veprimtarinë e parë të themi atë mbi përvjetorin e hapjes së minierës ju nuk keni gjë tjetër për të shtuar veç atyre që keni sjellë shkresërisht?

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Tani të jap edhe një shpjegim tjetër. Kredencialet ne i kemi hapur tani vonë domethënë mund të ketë rreth dy javë .

Z. I. Celibashi: I keni? I keni marrë me vones?

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Po tani po. Po janë pak me vonesë prandaj po them edhe me raportimet i kemi filluar pak me vonesë përderisa nuk kemi pasur edhe kredencialet.

Z. I. Celibashi: Në rregull, dakord!

Z. Leonard Doçi Sekretar i Përgjithshëm ,Bashkia Bulqizë: Ndërsa për pjesën tjetër do ju kthejmë informacion me email.

Z. I. Celibashi: Përgjigje me email. Mirë, faleminderit! Po përfaqësuesi i institucionit tjetër!

Përfaqësuese nga DROSHKSH Elbasan: Në lidhje me pretendimin e Partisë Demokratike se gjatë periudhës 4 muaj përpara zgjedhjeve vendore të datës 14

Zbardhi materialin audio

Ardita ÇAMI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*


Maj 2023 për emërimet afat shkurtëra në institucion. Përgjigjen e kemi dërguar me shkresë zyrtare, konfirmojmë edhe njëherë që për këtë periudhë kohore institucioni nuk ka kryer asnjë procedurë punësimi si rrjedhojë nuk ka asnjë punonjës së punësuar.

Z. I. Celibashi: Gjë tjetër nuk kemi?

Përfaqësuese nga DROSHKSH Elbasan: Jo, ju faleminderit!

Z. I. Celibashi: Dakord e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.15.03.2023*

15.03.2023
Ora 12:46

RENDI I DITËS

Projektakti “Vlerësim i raportimeve të veprimtarive me karakter publik të disa institucioneve, për periudhën 3 Mars – 9 Mars 2023.”

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z. Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,

Znj. I. Osmanaj

• **Parti Politike:**

• **Të tjerë:**

KRIIK, Qëndresa Qytetare.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me pikën tjetër.

Znj. M. Koja: Pika e dytë e rendit të ditës ka të bëjë me monitorimin dhe raportimin e veprimtarive për periudhën 3 Mars deri më 9 Mars 2023. Në total janë raportuar 272 veprimtari me karakter publik nga 50 institucione publike. Nga këto veprimtari 40 prej tyre janë në shkelje të afatit të raportimit, këto 40 veprimtari janë kryer nga 19 institucione. Gjatë procesit të verifikimit iu është kërkuar informacion zyrtarisht këtyre institucioneve për të dhënë shpjegimet e tyre dhe deri më tani kanë sjellë pretendime 13 institucione. Deri të Premten besoj mbyllim procedurat e verifikimit dhe dalim me vendimin përkatës pas vlerësimit.

Z. I. Celibashi: Mirë dakord faleminderit! Çështje të tjera nuk kemi në rendin e ditës. Seanca mbyllet, ditë të mbarë.

*Zbardhi materialin audio
Ardita ÇAMI*

